

Dr. Qëndrim Gashi, laureat i **"Shpërblimit mbështetës 2014"** të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, 10.02.2014



Fjala e kryetarit të Akademisë, akademik Hivzi Islami

Jemi mbledhur sot në mjediset e Akademisë për një rast të veçantë për të cilin nuk jemi tubuar asnjëherë në historinë tashmë katërdekadëshe të kësaj themelate. Jemi këtu për ta shpallur një çmim që e ka themeluar Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të cilin e ka emërtuar *"Shpërblimi mbështetës 2014"* dhe u jepet kandidatëve të moshës së re që kanë arritur rezultate të larta, të veçanta në fushën e shkencës dhe të artit. Ky çmim do të jetë tradicional dhe do të jepet në fillim të çdo viti. Fondi për këtë shpërblim krijohet nga donacionet.

Tashmë një kohë të gjatë Kryesia e Akademisë përgatitet për dhënien e këtij çmimi, që ishte nismë e kryetarit të mëparshëm, akademik Besim Bokshit, i cili besonte se përmes një forme tjetër financiare do ta jepte çmimin. Por kjo nuk u realizua, për disa arsye. E falënderoj shumë për idenë dhe përpjekjet e tij.

Në mbledhjen e saj nr. 230 të 31 dhjetorit 2013 Kryesia e themeloi këtë çmim dhe më 22 janar 2014 e shpalli konkursin publik për këtë qëllim. Në konkurs u paraqitën katër kandidatë nga fusha të ndryshme të shkencave dhe të arteve. Kryesia në mbledhjen e vet të mbajtur më 31 janar 2014 ka caktuar Komisionin vlerësues në përbërje kryetari i Akademisë Hivzi Islami, akademik Tahir Emra dhe anëtari korresp. Qamil Haxhibeqiri. Komisioni pasi e shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur dhe në përputhje me kushtet e kërkuara me konkurs, përzgjedhi për laureat të çmimit *"Shpërblimi mbështetës 2014"* dr. Qëndrim Gashin, profesor i asocuar në Departamentin e Matematikës të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të UP-së.

Si një shfaqje e re në jetën tonë arsimore e shkencore, dr. Qëndrim Gashi në moshën 18-vjeçare u diplomua në Departamentin e Matematikës të FSHMN-së, që ishte një përjashtim në Kosovë dhe më gjerë, dhe në moshën 23 vjeçare u doktorua në Universitetin e Çikagos të SHBA-ve. Në punën e tij arriti rezultate shumë të larta, të

veçanta në fushën e shkencës, konkretisht të shkencës së matematikës. Për realizimet e tij në këtë fushë u bë i njohur në botën e shkencës në të katër anët e globit.

Vlera materiale e *"Shpërblimit mbështetës 2014"* është 3.000 euro. Ky është dhe donacion i parë që vjen nga kompania Ing Office, Sh. P. K., Gjilan, me përfaqësuesin inxh. Mejdi Rexhepi në krye, i cili është këtu dhe në emër të Akademisë e falënderoj shumë. Shpërblimi i dhënë mbi bazë të këtij donacioni mendojmë se është një simbolikë e fuqishme, sepse përmes tij, kjo themelatë si më e larta e shkencës dhe e artit në Kosovë, ia njeh punën dhe meritat një të riu, pa i mbushur të 30-at, për atë që ka arritur deri më sot në fushën e shkencës, dhe e motivon për punë të mëtutjeshme produktive në shkencë, në këtë rast në shkencën e matematikës. Por ky shpërblim është një privilegj edhe për Akademinë që iu dha mundësia, në saje të donacionit në fjalë, ta laurojë një të ri me këto kualitete.

Raportin vlerësues për punën dhe rezultatet e arritura të dr. Qëndrim Gashit në shkencën e matematikës do ta paraqesë anëtari korresp. dr. Qamil Haxhibeqiri, anëtar i komisionit dhe profesor e bashkëpunëtor i laureatit Gashi.